

VENDIM
Nr. 54, datë 9.10.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 9.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (B) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Bahrije Lluka, përfaqësuar nga avokat Erdi Prifti, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Ministria e Shëndetësisë, në mungesë.

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pukë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4408, datë 6.11.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm të çështjes administrative nr. 31003-01713-00-2019 regjistri, datë 6.9.2019, në shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë.

Detyrimi i Gjykatës së Lartë të gjykojë çështjen e kërkuarës brenda gjashtë muajve.

Detyrimi i subjekteve të interesuara të paguajnë shpenzimet gjyqësore, sipas faturës nr. 2/2025, datë 16.1.2025, të përgatitjes së ankimit kushtetues individual nga përfaqësuesi.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 43, 124, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1, dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 28, 49, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarës Bahrije Lluka (*kërkuarja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pukë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuarja ka qenë në marrëdhënie pune pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pukë, në pozicionin e infermieres në Spitalin e Pukës, për periudhën 1.1.2009 deri më 15.3.2016. Me shkresën nr. 4987/1, datë 30.10.2015, Ministria e Shëndetësisë i ka dërguar Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pukë “Strukturën analitike të Shërbimit Spitalor Pukë”, sipas së cilës kishte ndryshuar numri i punonjësve. Mbi këtë bazë, me shkresën nr. 206 prot., datë 14.11.2015, kërkuarja është njoftuar për

fillimin e bisedimeve për zgjidhjen e kontratës së punës, në mbështetje të neneve 141-145 të Kodit të Punës (KP). Me shkresën nr. 287 prot., datë 27.11.2015 të drejtorit të Shërbimit Spitalor Pukë është zgjidhur kontrata e punës me kërkuesen, duke iu ndërprerë marrëdhëniet financiare në datën 13.3.2016, bazuar në nenin 143, pika 1, të KP-së, për shkak të afatit të njoftimit referuar vjetërsisë së saj në punë. Sipas këtij urdhri, kërkuesja do të përfitonte pushimet vjetore të pakryera deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe bazuar në nenin 145 të KP-së, edhe shpërblim për vjetërsi në punë në masën 3,5 paga.

2. Duke mos qenë dakord me sa më sipër, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pukë, me objekt deklarin e pavlefshmërisë së veprimeve administrative, shkresave nr. 4987, datë 30.10.2015 dhe nr. 4987/1, datë 30.10.2015 të Ministrisë së Shëndetësisë për miratimin dhe dërgimin e strukturës analitike të Shërbimit Spitalor Pukë, si dhe nr. 287 prot., datë 27.11.2015 të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pukë, për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme e të pajustificuara; konstatimin e shkeljes së të drejtave, lirive e interesave kushtetues e ligjorë; rikthimin e paditëses (kërkueses) në vendin e mëparshëm të punës; detyrimin e palëve të paditura ta dëmshpërblejnë me 3 paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, 2 paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, 12 paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme pa shkaqe të justifikuara të kontratës së punës, 12 paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme pa shkaqe të arsyeshme të kontratës së punës dhe 20 paga mujore shpërblim për vjetërsinë në punë prej 40 vitesh, duke iu referuar pagës bruto në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2481, datë 19.5.2016, ka shpallur moskompetencën tokësore dhe i ka dërguar aktet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, e cila, me vendimin nr. 631 (550), datë 3.10.2016, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar palën e paditur të shpërblejë paditësen (kërkuesen) me 2 paga mujore për mosrespektim të procedurës së njoftimit, sipas nenit 114, pika 5, të KP-së dhe rrëzimin e pjesës tjetër të padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesja.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1625, datë 28.5.2019, ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duke detyruar palën e paditur që t'i paguajë paditëses (kërkueses) 11.5 paga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë dhe lënien në fuqi të vendimit për pjesën tjetër. Kundër vendimit kërkuesja ka paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë, ku është regjistruar çështja nr. 31003-01713-00-2019, datë 6.9.2019.

5. Në datën 24.4.2023, në pritje të shqyrtimit të çështjes së saj, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1993, datë 24.5.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se edhe pse çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja "b", të Kodit të Procedurës Civile (KPC), kjo vonesë është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Sipas atij kolegji, mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, i cili ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përcaktuar edhe kritere transparente për marrjen në shqyrtim sipas radhës së vjetërsisë të çështjeve që i janë caktuar, për rrjedhojë nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme prej tij.

6. Në datën 22.10.2024 kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes së saj. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi është njohur edhe me informacionin e paraqitur nga gjyqtari relator, me vendimin nr. 00-2024-4408, datë 6.11.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, mbi të njëjtat argumente si më sipër. Edhe sipas atij kolegji, vonesa e gjatë në shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete është

rrjedhojë e një problematike të përgjithshme, që ka krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore, vështirësi këto që janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme që krijon procesi i reformës në drejtësi. Kolegji Civil ka vlerësuar se referuar numrit të përgjithshëm të çështjeve të regjistruara në atë gjykatë dhe atyre me natyrë administrative, si dhe faktit të mungesave të gjyqtarëve, aktualisht Kolegji Administrativ po përfundon shqyrtimin e çështjeve të themelit të regjistruara në vitin 2017. Po sipas atij kolegji, mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, i cili ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përcaktuar edhe kritere transparente për marrjen në shqyrtim sipas radhës së vjetërsisë të çështjeve që i janë caktuar.

7. Në datën 20.1.2025 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij dhe Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 28.3.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. Kërkesja, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, për shkak se çështja e kërkeses edhe pse është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 6.9.2019 nuk është gjykuar ende, në kundërshtim me afatin për gjykimin e çështjeve në atë gjykatë, që është 1 vit sipas nenit 399 të KPC-së dhe 90 ditë sipas ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Kërkesja ka paraqitur prova të plota përpara gjykatës dhe nuk ka kërkuar kryerjen e ndonjë akti ekspertimi, si dhe nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për shtyrje të gjykimit, pra nuk është bërë shkak për vonesat. Kjo situatë, duke pasur parasysh edhe moshën e kërkeses (pensioniste), i ka krijuar një gjendje të rënduar psikologjike, pa pasur parasysh edhe vështirësitë e saj ekonomike. Çështja në pritje të gjykimit ka për objekt të padisë marrëdhënien e punësimit të kërkeses dhe shpërblimin e dëmit që rrjedh prej saj, e cila, për shkak të pasojave me natyrë sociale dhe financiare, përbën interes vetjak dhe jetësor për kërkesen që është pensioniste, ndaj duhet të trajtohet me përparësi.

8.2. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme*, pasi Kolegji Civil ka vepruar pa shqyrtuar çështjen, përderisa në vendim shprehet se këto lloj mosmarrëveshjesh duhet të gjykohen me prioritet, ndërsa në fund ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

8.3. *Standardit të arsyetimit*, pasi vendimi i Kolegjit Civil është i paarsyetuar dhe bie ndesh edhe me vetë shpjegimet e tij.

8.4. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Kolegji Civil ka disponuar jo në bazë të përcaktimeve të ligjit procedural civil dhe atij administrativ.

9. Subjektet e interesuara, Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pukë, nuk kanë paraqitur parashtrime me shkrim edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për

grykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, për të cilin ka pretenduar se i është cenuar e drejta për grykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

12. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, kërkesja ka paraqitur ankim kushtetues individual, pasi i është drejtuar më parë Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme dhe përsheptimin e grykimit, në zbatim të nenit 399/6, pika 1, shkronja “c”, të KPC-së, për të cilën ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin. Për rrjedhojë, konsiderohet se është përmbushur kriteri i shterimit të mjeteve juridike në dispozicion.

13. Kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe se vendimi i Gjykatës së Lartë objekt ankimi mban datën 6.11.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 20.1.2025, brenda afatit 4-mujor.

14. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkesja ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *kohëzgjatjes së paarsyeshme* të procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, si edhe në drejtim të *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme, standardit të arsyetimit dhe parimit të sigurisë juridike*, të cilat, edhe pse janë ngritur si pretendime të mëvetshme, në thelb kanë të bëjnë me mënyrën sesi Kolegji Civil ka arsyetuar dhe argumentuar vendimin e tij për rrëzimin e kërkesës së kërkeses për kohëzgjatjen e grykimit dhe përsheptimin e procedurave. Për rrjedhojë, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtyre pretendimeve, ato do të trajtohen në vijim në këndvështrim të së drejtës për grykim brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për grykim brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkesja ka pretenduar se çështja e saj është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 6.9.2019, por nuk është gjykuar ende, në kundërshtim me afatin për grykimin e çështjeve në atë gjykatë, që është 1 vit sipas nenit 399 të KPC-së dhe 90 ditë sipas ligjit nr. 49/2012. Në lidhje me sjelljen e saj, kërkesja ka parashtruar se nuk është bërë shkak për vonesat, se ka paraqitur prova të plota përpara gjykatës dhe nuk ka kërkuar kryerjen e ndonjë akti ekspertimi, si dhe nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për shtyrje të grykimit. Sipas saj, objekti i grykimit është marrëdhënia e punësimit dhe shpërblimi i dëmit, që, për shkak të pasojave me natyrë sociale dhe financiare, përbën interes vetjak dhe jetësor për kërkesen që është pensioniste, ndaj duhet të trajtohet me përparësi. Kjo situatë, duke pasur parasysh edhe moshën e saj, i ka krijuar kërkeses një gjendje të rënduar psikologjike, pa pasur parasysh edhe vështirësitë e saj ekonomike. Kërkesja ka pretenduar se Kolegji Civil, edhe pse shprehet se këto mosmarrëveshje duhet të gjykohen me prioritet, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, vendim që është i paarsyetuar pasi ajo gjykatë nuk ka disponuar në bazë të përcaktimeve të ligjit procedural civil dhe atij administrativ.

16. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një grykimi të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e grykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi (*shih vendimet nr. 27, datë 11.4.2024; nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata vëren se çështja e kërkujes është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 6.9.2019, me numër 31003-01713-00-2019 dhe ndonëse aktualisht kanë kaluar 6 vjet që prej datës së regjistrimit, referuar të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se ende nuk ka një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj nga Kolegji Administrativ i asaj gjykate. Po kështu, sipas informacionit të datës 6.10.2025 të dërguar prej Gjykatës së Lartë përmes postës elektronike, rezulton se çështja e kërkujes “*ndodhet ende në fazë studimi dhe aktualisht nuk ka një datë të planifikuar në sistemin ICMIS*”. Për rrjedhojë, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkujes ka tejkaluar afatin 2-vjeçar, që sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së është parashikuar si i arsyeshëm për gjykimin civil në Gjykatën e Lartë dhe atë 90-ditor të parashikuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 për gjykimin administrativ në po atë gjykatë. Gjykata vëren, gjithashtu, se kohëzgjatja tërësore e procesit gjyqësor deri në këtë fazë të tij është mbi 9 vjet, referuar datës së regjistrimit të padisë në gjykatën e shkallës së parë (datë 30.5.2016).

18. Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave, në kuptim të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete, vlerësohet nën dritën e këtyre kriterëve: i. sjellja e kërkujesit; ii. kompleksiteti i çështjes; iii. sjellja e autoriteteve; iv. rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi. Për sa u përket kriterëve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkujeses, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj për vlerësimin e tyre (*shih vendimet nr. 15, datë 3.4.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata thekson se në rastin konkret nuk konstatohet ndonjë shkak ose rrethanë e re, ose e ndryshme për të arritur ajo në një qëndrim të ndryshëm për sa i përket respektimit të tyre. Për rrjedhojë, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata vlerëson të ndalet në vijim vetëm në analizën e kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuësja* në rastin konkret për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes së saj.

19. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tilla si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkujesit verifikohet rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata, referuar qëndrimin të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vëren se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile që nuk kërkojnë ndonjë trajtim të veçantë prioritar kanë megjithatë të drejtë, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm dhe ato nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Sipas asaj gjykate, një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak dhe faktorë të tillë të një natyre të përgjithshme mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në përcaktimin e çdo kohëzgjatjeje të procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të afta, në vetvete, të justifikojnë vonesa të një mase të tillë (*shih ARB sh.p.k. e të tjerë kundër Shqipërisë, §§§ 111, 118, 122, datë 27 maj 2025*).

20. Në analizë të kriterëve si më sipër, Gjykata vëren se në rastin konkret në shqyrtim thelbi i çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuësja ka të bëjë me marrëdhëniet e punës dhe pasojat që rrjedhin prej kësaj mosmarrëveshjeje, për rrjedhojë kjo çështje, për nga natyra e saj, lidhet me interesa *vetjakë dhe jetësorë*, të tillë që duhet të shqyrtohen me prioritet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për më tepër, kërkuësja ka arritur të parashtrojë shkaqe objektive, specifike dhe të mjaftueshme për të provuar se çështja është e një natyre të tillë që interesi i saj rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore, duke pasur parasysh këtu edhe se ajo është pensioniste dhe në një moshë të caktuar. Për rrjedhojë, Gjykata, në kontekst të rrethanave të çështjes konkrete, si dhe në drejtim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuësja nga vonesa në gjykim, çmon se është argumentuar dhe provuar rreziku për interesat e kërkujeses, natyra dhe rëndësia

e të cilave justifikojnë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së saj nga Gjykata e Lartë.

21. Në përfundim, Gjykata, duke pasur parasysh periudhën prej 6 vjetësh gjatë së cilës çështja është në pritje të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

22. Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes së kërkueses, si dhe mundësitë aktuale të Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon që, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, të urdhërojë detyrimin e asaj gjykate për shqyrtimin e çështjes me përparësi.

C. Për shpenzimet e përfaqësimit në Gjykatën Kushtetuese

23. Në objektin e ankimit kushtetues individual kërkuesja ka kërkuar edhe detyrimin e subjekteve të interesuara që të paguajnë shpenzimet gjyqësore të përgatitjes së ankimit kushtetues individual nga përfaqësuesi i saj në këtë gjykim. Për këtë qëllim, ajo ka paraqitur faturën e datës 16.1.2025, të lëshuar nga përfaqësuesi i saj Erdi Prifti, në vlerën 25,000 lekë (pa TVSH), të përshkruar si pagesë për ofrimin e shërbimit të përgatitjes së ankimit kushtetues individual.

24. Gjykata vëren se në nenin 28 të ligjit nr. 8577/2000 janë parashikuar rregullat për sa u takon shpenzimeve gjyqësore, sipas të cilave, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifën gjyqësore (*pika 1*); kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi (*pika 2*). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, sipas së cilit me paraqitjen e kërkesës paraqitet edhe akti që provon shlyerjen e tarifave përkatëse (*pika 2*); kur vendoset pranimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (*pika 4*).

25. Gjykata ka theksuar se në parim çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit individual është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë në mënyrë të pajustificuar të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Po kështu, referuar përmbajtjes së dispozitave si më sipër, *së pari*, disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe, *së dyti*, një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri kur deklarohet mbyllja e seancës plenare nga Gjykata. Individi ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme, ndaj ai duhet të paraqesë edhe aktet që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Sipas udhëzimit të përbashkët nr. 18, datë 5.8.2020, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërbimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore” (*udhëzimi nr. 18/2020*), shpenzimet për ofrimin e mbrojtjes juridike për përfaqësimin në Gjykatë përcaktohen në vlerat 50,000 lekë dhe 60,000 lekë, ndërsa për shërbime juridike jashtëgjyqësore përcaktohen në vlerat 25,000 lekë (përgatitje kërkesë) dhe 500 deri në 1,500 lekë ora (ofrimi i ndihmës juridike në formën e këshillimit – shih rubrikat I dhe II të shtojcës 1 “*Tarifat e shërbimeve juridike të avokatëve të ndihmës juridike*”). Nga ana tjetër, kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me: kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar (*shih vendimin nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa i takon subjektit që ngarkohet për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit, Gjykata ka theksuar se natyra dhe objekti i gjykimit kushtetues ndryshojnë nga gjykimi i zakonshëm, për sa kohë që në gjykimin kushtetues individi kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e

veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, që i kanë pasjellë atij cenimin e të drejtave themelore, ndaj përgjegjësia në këtë gjykim i takon vetë shtetit. Kjo logjikë ndiqet nga rregullimet ligjore për kompensimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ku në gjykimin e zakonshëm thirren të paditur Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave (*neni 399/4, pika 2, i KPC-së*) (*shih vendimin nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa më sipër, Gjykata vëren se kërkitimi për shpenzimet gjyqësore (tarifa e përgatitjes së ankimit kushtetues individual) është paraqitur nga kërkuuesja në ankimin kushtetues individual, duke bashkëlidhur edhe faturën tatimore të lëshuar nga avokati, në të cilën përshkruhet shërbimi i ofruar prej tij dhe vlera e këtij shërbimi në masën 25,000 lekë, vlerë kjo e përcaktuar edhe nga udhëzimi nr. 18/2020 për shërbimin juridik jashtëgjyqësor, përgatitje kërkesë në Gjykatë. Këto shpenzime, duke pasur parasysh natyrën e çështjes konkrete, që ka të bëjë me konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor, i ngarkohen Ministrisë së Financave. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkesa për shpenzimet e përfaqësimit është e drejtë dhe pranohet.

28. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses janë të bazuara sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 28, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4408, datë 6.11.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
4. Detyrimin e Gjykatës së Lartë ta shqyrtojë çështjen me përparësi.
5. Shpenzimet e përfaqësimit të kërkueses në vlerën 25,000 lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 9.10.2025.

Shpallur më 30.10.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim